

**AUTORITETI I KONKURRENCËS  
I SHQIPËRISË**

Nr. 350 Prot.  
Prishtinë më 15/09/2009

**KOMISIONI KOSOVAR I  
KONKURRENCËS**

Nr. 2 Prot.  
Prishtinë më 15/09/2009

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

**NDËRMJET:**

**AUTORITETIT TË KONKURRENCËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT  
KOSOVAR TË KONKURRENCËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), si dhe në Ligjin Nr 2004/36, datë 08.09.2004 "Për Konkurrencën", lidhet ky Memorandum Mirëkuptimi midis palëve:

**Autoritetit të Konkurrencës së Shqipërisë** (në vijim **AKSH**) me seli Rruga "Sami Frashëri, Nr. 4, Kati IV", Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari Znj. Lindita MILO (LATI);

**si dhe**

**Komisionit Kosovar të Konkurrencës** (në vijim **KKK**), me seli ne Rr."Muharrem Fejza" Lagjja Spitalit, 10 000 Prishtinë, përfaqësuar nga Kryetari Z. Osman Ejupi;

**AUTORITETI I KONKURRENCËS I SHQIPËRISË DHE KOMISIONI KOSOVAR I KONKURRENCËS**  
**(këtu e më poshtë palët):**

Shprehin vullnetin të bashkëpunojnë në fushën e konkurrencës, ligjit dhe politikës së konkurrencës,

Synojnë krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e lidhjeve dypalëshe,

Bazohen në parimet e barazisë dhe përfitimit të përbashkët,

Kanë parasysh rolin e rëndësishëm të politikës së konkurrencës në promovimin e zhvillimit efektiv në një ekonomi tregu,

## **DUKE QENË SE:**

**Autoriteti i Konkurrencës i Shqipërisë** është organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta dhe përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kontrollon rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre dhe bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën;

Dhe

**Komisioni Kosovar i Konkurrencës** është organ rregullativ i konkurrencës, i pavarur dhe ka përgjegjësinë për mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës, kontrollon sjelljet e ndërmarrjeve në treg, nxjerr akte plotësuese normative për zbatimin e ligjit dhe bashkëpunon me institucione shtetërore;

Kanë rënë dakord si vijon:

### **Neni 1.**

#### **Objekti**

Objekt i këtij memorandumi është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e ligjit dhe politikës së konkurrencës si në çështje të përgjithshme të konkurrencës ashtu edhe në rastet e veçanta.

### **Neni 2.**

#### **Bashkëpunimi midis palëve**

1. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi krijohen mekanizmat ligjorë dhe institucional për të

parandaluar dhe ndaluar çdo sjellje që mund të ndikojë negativisht konkurrencën në Shqipëri ose në Kosovë dhe për të cilën palët bien dakord:

- Të shkëmbejnë informacion në kryerjen e hetimeve për sa i përket sjelljeve anti konkurrese dhe shkelje të tjera të ligjit të konkurrencës;
- Ti mundësojnë secilës palë raportet vjetore, përshkrime të rasteve, studime mbi politikën e konkurrencës dhe materiale të tjera të përshtatshme mbi legjislacionin e konkurrencës;
- Të ofrojnë ndihmë të nevojshme në krijimin e marrëdhënieve të nevojshme me institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të shteteve përkatëse ;
- Të ofrojnë mundësinë për të shkëmbyer specialistë me synim shkëmbimin e eksperiencës;

2. AKSH ofron eksperiencën e tij KKK për sa i përket krijimit të një ligji efektiv, të një institucioni ligjor, krijimin e kulturës dhe advokacisë së konkurrencës.
3. Me qëllim të plotësimit të kushteve të pikës 2 të mësipërme, ekspertët e ASHK mund të vizitojnë KKK për konsultime në lidhje me çështjet e përmendura më sipër.
4. Dispozitat e këtij memorandumi do të zbatohen në rastet kur shqyrtohen sjellje anti konkurrese në treg të cilat mund të kenë ndikim negativ mbi konkurrencën në Republikën e Shqipërisë ose në Republikën e Kosovës.
5. Për qëllim të këtij Memorandumi me shprehjen “sjellje anti konkurrese në treg të cilat mund të kenë ndikim negativ mbi konkurrencën “ do të kuptojmë::
  - Abuzimin me pozitën dominuese ;
  - Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve të cilat mund të rezultojnë në kufizime, shtrembërime ode deformime të konkurrencës;
  - Kontrollin e përqendrimeve.

### **Neni 3**

#### **Komunikimi midis palëve**

1. Nëse një nga palët vërteton se sjellja e një ndërmarrje në territorin e saj do të ketë ndikim negativ në territorin e shtetit tjetër, ajo njofton pa vonese palën tjetër

në lidhje me këtë rast.

2. Nëse një nga palët vërteton se konkurrenca në shtetin që i përket mundet të ndikohet negativisht nga veprimet e një ndërmarrjeje që vepron në shtetin tjetër, ajo njofton pa vonese palën tjetër në lidhje me këtë rast.
3. Njoftimi duhet të dërgohet me shkrim dhe të përmbajë një përshkrim të shkurtër të rastit, referencën në aktet ligjore, si dhe informacionin e nevojshëm të cilin pala dërguese e konsideron të rëndësishëm për këtë rast.
4. Pala marrëse e informacionit vlerëson informacionin e marrë dhe informon palën dërguese për rezultatet.

#### **Neni 4**

#### **Kërkesa për informacion**

1. Në rastet e sjelljeve potencialisht anti konkurruese, secila palë ka të drejtën të kërkojë informacion palës tjetër mbi ndërmarrjen në fjalë. Pala tjetër ka të drejtën ta refuzojë dërgimin e informacionit të kërkuar nëse ky informacion mund të sigurohet nga ana e vet ndërmarrjes në shtetin e palës kërkuese. Kërkesa mundet të refuzohet bazuar edhe në parimet e konfidencialitetit.
2. Pala kërkuese duhet të deklarojë arsyet dhe qëllimin e kërkesës së saj .
3. Informacioni i kërkuar duhet të dërgohet brenda tre muajve nga marrja e kërkesës.
4. Informacioni i dërguar nuk duhet të bëhet publik, përveç rasteve kur palët bien dakord për ta publikuar atë.
5. Palët mund të refuzojnë bashkëpunimin vetëm në rastet e mbrojtjes së sekretit tregtar ose sekreteve të tjera bazuar në ligjet e tyre perkatëse.

#### **Neni 5**

#### **Dispozita përfundimtare**

1. Asnjë ndryshim nuk mund t'i bëhet këtij Memorandumi në mënyrë të njëanshme, përveçse me shkrim, si dhe pasi palët të kenë rënë dakord

paraprakisht midis tyre dhe të kenë autorizuar ndryshimin nëpërmjet nënshkrimit nga titullarët e palëve.

2. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga **AKSH** dhe **KKK** dhe është i vlefshëm, deri sa palët të kërkojnë me shkrim shfuqizimin ose shuarjen e tij.
3. Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme e këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë, nga **AKSH** dhe **KKK**, por duke lajmëruar me shkrim 30 ditë më parë palën tjetër.
4. Memorandumi hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e tij nuk është në tejkalim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave e tyre.
5. Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë Memorandumin për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Memorandumin, sipas përcaktimit në pikën 4.3.
6. Për lehtësimin dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm për zbatimin e këtij memorandumi, palët bien dakord që të caktojnë personat dhe mënyrën e kontaktit midis tyre, në një afat prej 30 ditë nga dita nënshkrimit.

#### Neni 6

Memorandumi i Mirëkuptimit, është i shkruar në gjuhën shqipe, në dy kopje, nga një për secilën palë, nënshkruhet dhe hyn në fuqi me datën e nënshkrimit .

**Lindita MILO(LATI)**

**KRYETAR**

**Autoriteti i Konkurrencës i Shqipërisë**

**Osman EJUPI**

**KRYETAR**

**Komisioni Kosovar i Konkurrencës**